



Departamenti i Prokurimit

Prishtine: datë, **28.02.2022**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.02.2022 të parashtruar nga Grupi i OE **“VIA EGNATIA” Shpk&”Rosi trade” shpk**; lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Intervenime emergjente – pastrimi I shtratit te lumenjeve dhe kanalizimit atmosferik”**, me Nr. të Prok: **616-21-8437-5-2-1** dhe numër te brendshëm 616 21 005 511 nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit te OE **“VIA EGNATIA” Shpk & ”Rosi trade” shpk**; të dt. 25.02.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Intervenime emergjente – pastrimi I shtratit te lumenjeve dhe kanalizimit atmosferik”** me **616-21-8437-5-2-1** dhe Nr. Brendshëm 616 21 005 521, kundër Vendimit te *Njoftimit te AK* së, të datës: 21/02/2022 te publikuar ne web-faqe te KRPP-së
2. AK vendos qe ta kthej ne rivlerësim aktivitetin e prokurimit: **“Intervenime emergjente – pastrimi I shtratit te lumenjeve dhe kanalizimit atmosferik”** me numër te prokurimit: **616-21-8437-5-2-1** dhe Nr. Brendshëm 616 21 005 521, ne menyre qe komisioni për rivleresim ta riezaminoj edhe njeher ofertën e grupit te OE **“VIA EGNATIA” Shpk & ”Rosi trade” shpk** dhe te kerkoj sqarime lidhur me licensen nga MMPH dhe kontraten me KMDK-ne.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grupi i OE **“VIA EGNATIA” Shpk&“Rosi trade” shpk** me datë 25.02.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Intervenime emergjente – patrimi I shtratit te lumenjeve dhe kanalizimit atmosferik”**, me Nr. të Prok: 616-21-8437-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 21 005 521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 28.02.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

AK duke u bazuar ne nenin 72 te LPP (Dokumentacioni dhe informacioni shtese), do te kerkoj nga Grupi i OE **“VIA EGNATIA” Shpk&“Rosi trade” shpk sqarime lidhur me licensen nga MMPH dhe kontratën me KMDK-ne si dhe riezaminimin e ofertave tjera ne këtë aktivitet te prokurimit për pastrimin ne shtratit te lumenjve dhe kanalizimit atmosferik ne Komunën e Prishtinës.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më larte ka vendosur si ne dispozitiv.
Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.
Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij Vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit